

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5556  
E hënë, 20 gusht 2018  
çmimi 0.40 €

Të hyrat nga policat e sigurimeve arrijnë mbi dy milionë euro

Intervistë me drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Blerim Pushkolli



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



## AKTUALE

PËR  
HERONJTË F.5



Vlora ÇITAKU

ME FOL -  
SERM, MOS ME  
FOL - DUKAT F.11



Shkruan: Jakup  
KRASNIQI



FLET PËR "EPOKËN E RE", SABRI BAJGORA | FAQE 4-5

## BIK-u ka arritur rezultate të prekshme në luftimin e ekstremizmit

- Shpresojmë se ndërtimi i Xhamisë së Madhe të fillojë gjatë këtij viti

Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Sabri Bajgora, ka bërë me dije se një prej sfidave kryesore të kësaj bashkësie fetare mbetet ruajtja e rinisë nga mësimet ekstremiste. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se BIK-u është angazhuar mak-

simalisht për edukimin e drejtë të të rinjve dhe për mbajtjen e tyre larg nga mësimet ekstremiste. Sipas tij, ky është detyrim fetar e kombëtar i kësaj bashkësie fetare. Bajgora ka theksuar se BIK-u në vazhdimësi, me institucionet e veta, ka arritur rezultate të prekshme në luftimin e

ekstremizmit. Ai ka treguar se gjatë këtij viti pritet të fillojë ndërtimi i Xhamisë së Madhe në Prishtinë. Kryeimami Bajgora ka thënë se si çdo vit, edhe këtë herë për ta kryer Haxhin, në Mekë dhe në vendet e tjera të shenja, janë të pranishëm edhe 1 080 besimtarë tanë nga Kosova



## Dialogu rinis në pjesën e parë të shtatorit

Në pjesën e parë të muajit shtator do të mbahet takimi i radhës në kuadër të dialogut për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kështu ka bërë me dije presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, për gazetën "Epoka e re". Por, ai ka thënë se në këtë takim ende nuk është specifikuar se për çfarë do të diskutojë me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. I pari i vendit u ka bërë thirrje partive opozitare të bëhen pjesë e dialogut, duke thënë se bashkëngjitja e opozitës në këtë proces është e mirëseardhur | FAQE 6



Përgënjeshtrohen me fakte pretendimet se datëlindja e Adem Jasharit ishte falsifikuar

| FAQE 7

## EKONOMI

BANKAT U MARRIN BIZNESEVE PESË PËR QIND TARIFË PËR DEPONIMIN E PARAVE METALIKE F.9

## SPORT

SUPERLIGA NIS ME BEFASI. DRITA KONFIRMON KANDIDATURËN PËR TITULL

ZOLLNERI, TRAJNER I KB PRISHTINA F.18

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878


**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Referendumi për emrin në Maqedoni, problem mbeten listat zgjedhore

Maqedonia, me një popullsi të vlerësuar prej pak më shumë se dy milionë banorësh ka një milion e 800 mijë votues të regjistruar. Nëse referendumi vendos për ndryshimin e emrit në Republika e Maqedonisë së Veriut, atëherë ky shtet do të bëhet anëtar i 30 i NATO-s dhe do t'i nisë bisedimet në qershorin e 2019-s për anëtarësim në BE

**SHKUP, 19 GUSHT** - Autoritetet në Maqedoni po bëjnë përgatitje për referendumin e 30 shtatorit, që mund të vlerësohet si historik, për shkak të pritjeve për ndryshimin e emrit të vendit. Por, vëzhguesit lokalë vërejnë se regjistri i votuesve nuk është pastruar, ndërsa paralajmërojnë për manipulime të mundshme. Para referendumit për ndryshimin e emrit të Maqedonisë, të caktuar për më 30 shtator, te një pjesë e shoqërisë civile dhe analistëve janë shtuar dilemat nëse regjistri zgjedhor po vazhdon të jetë i manipuluar si në periudhën e pushtetit të kaluar. Maqedonia, me një popullsi të vlerësuar prej pak më shumë se dy milionë banorësh, sepse nuk është bërë një regjistrim që prej vitit 2002, ka një milion e 800 mijë votues të regjistruar. Ende ka njerëz të vdekur të cilët figurojnë në regjistrin zgjedhor, sipas shoqërisë civile. Por, Komisioni i ri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk i pranon raportet. Shifra prej një milion e 800 mijë votuesve është reale, sipas Komisionit.



Qeveria e Maqedonisë nuk ka dhënë ende hollësi mbi shpenzimet e planifikuara për fushatën, për referendumin që tashmë në realitet ka filluar, e prej nga do t'i sigurojë ato mjete financiare.

Autoritetet qeveritare, nga ana tjetër, presin nga diaspora që të marrë pjesë në referendum, por numri i atyre që janë regjistruar deri tani në diasporë mezi kalon shifrën 1.000. Shkalla e nevojshme e daljes së votuesve në referendum është 50 për qind plus një.

Opozita maqedonase nuk ka vendosur ende nëse do të bëjë thirrje për bojkot ose jo. Nëse referendumi vendos për ndryshimin e emrit në Republika e Maqedonisë së Veriut, atëherë ky shtet do të bëhet anëtar i 30 i NATO-s dhe do të nisë bisedimet në qershorin e 2019-s për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në anën tjetër, ende nuk dihet se sa administratorë do të shkojnë nga Maqedonia në diasporë për të zbatuar procesin e referendumit.

## BDI-ja fton diasporën që të votojë në mënyrë elektronike në referendum

**SHKUP, 19 GUSHT** - Bashkimi Demokratik për Integrim apelon te diaspora e nderuar nga Maqedonia të shfrytëzojë të drejtën e votës duke u regjistruar për t'u bërë pjesë e ndërtimit të ëndrës së përbashkët për një Maqedoni plotësisht të integruar në NATO dhe në Bashkimin Evropian. "Duke marrë parasysh se një numër i madh i mërgimtarëve këto ditë gjenden në vendlindje, ju njoftojmë që të drejtën e regjistrimit mund ta realizojnë edhe në mënyrë elektronike në uebfaqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve deri më 23 gusht: <https://dijaspora.sec.mk/Default.aspx>. Gjithashtu, ftojme mërgimtarët e nderuar të cilët nuk do të

regjistrohen për të votuar në diasporë, të vijnë dhe ta realizojnë të drejtën e tyre të votës në Maqedoni më 30 shtator", thuhet në njoftimin e BDI-së. Referendumi për integrim të vendit në NATO dhe BE është me rëndësi të jashtëzakonshme për të ardhmen e vendit dhe të qytetarëve, prandaj ftojme të gjithë elementet përbërëse të shoqërisë që të mobilizohen për ta përcaktuar të ardhmen e sigurt.



Ministri i Diasporës, Edmond Ademi, thotë se disa përfaqësi diplomatike kanë mjaftueshëm administratorë të punësuar për zbatimin e referendumit, ndërsa disa të tjera janë me numër tejet

të ulët. Ai shton se deri në mbylljen e afatit të paraqitjes së votuesve nëpër ambasada nuk mund të parashihet se sa do të jetë nevoja për dërgimin e stafit nga Maqedonia në diasporë.

## Ndryshimet në Qeveri surprizë, nga 13 ministra 11 do jenë femra



**TIRANË, 19 GUSHT** - Edi Rama pati premtuar se në javën e fundit të gushtit do të mblidhte Asamblenë e PS-së për të shikuar performancën e ministrave. Tashmë burime që nuk duan të identifikohen thonë se kryeministri e ka piketuar qeverinë e re në shtator të këtij viti, ku do të ketë surpriza. I pyetur me insistim se çfarë nënkupton me "surpriza", ai tha se "nga 13 ministra, 11 prej tyre do jenë femra". Por vetëm kaq tha personi që rri pranë kryeministrit. Ai nuk sqaroi nëse femrat min-

istre që janë sot a do të jenë prapë në kabinetin e ri apo do të jenë 11 femra të reja ministre. Nuk tha se cilët do të jenë dy burrat ministra mes këtij seksi femëror ministror. A do të jetë zëvendëskryeministria Senida Mesi prapë në detyrë apo do të largohet për t'u bërë gati si kandidatë për kryetare bashkie në Shkodër ku Edi Rama ka thënë pak javë më parë, se do ta fitojë bashkinë e Shkodrës. Po kështu nuk sqaroi nëse këto dy burra ministra që do mbeten a do të jenë Fatmir Xhafa,

Ditmir Bushati, Niko Peleshi, Damian Gjinkuri apo ndonjë tjetër ministër. Cili mashkull ministër do të jetë si "veshka mes dhjavit" në këtë kabinet ministrash, ku 11 janë femra, apo asnjëri prej ministrave të sotëm sepse mund të marrë dy ministra të tjerë? E fundit, cila femër ministre do jetë nga ShBA-ja, prej diasporës shqiptare? Edi Rama e ka krijuar qeverinë e tij femërore, e cila do të jetë e para në botë me kaq shumë femra ministre.

## Meta viziton familjarët e viktimës së Genovas

**TIRANË, 19 GUSHT** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka shkuar për ngushëllime te familja e Admir Bokrinës në Shkodër, i cili humbi jetën tragjikisht pak ditë më parë, ku u shemb ura

Morandi në Genova. Kreu i shteti e ka cilësuar këtë një ngjarje tragjike, duke shtuar se nuk ka fjalë për këtë humbje të madhe. Ai ka ngushëlluar familjarët e Bokrinës, ndërsa u

ka bërë apel që të bëhen më të fortë.

"Nuk kanë fuqi fjalët për të shprehur dhimbjen e ngushëllimin për këtë rast tragjik. Tragjedia e Genovas të na ndih-

mojë të reflektojmë për sigurinë e veprave publike Duhet të marrim masa të forta për parandalimin e tragjedive të tilla në vendin tonë", u shpreh Meta.





# Urime festa e Kurban Bajramit!



Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

**KOSOVA** eRE

Flet për "Epokën e re", Sabri Bajgora

# BIK-u ka arritur rezultate të prek

## - Shpresojmë se ndërtimi i Xhamisë së Madhe të fillojë gjatë këtij viti



Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Sabri Bajgora, ka bërë me dije se një prej sfidave kryesore të kësaj bashkësie fetare mbetet ruajtja e rinisë nga mësimet ekstremiste. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se BIK-u është angazhuar maksimalisht për edukimin e drejtë të të rinjve dhe për mbajtjen e tyre larg nga mësimet ekstremiste. Sipas tij, ky është detyrim fetar e kombëtar i kësaj bashkësie fetare. Bajgora ka theksuar se BIK-u në vazhdimësi, me institucionet e veta, ka arritur rezultate të prekshme në luftimin e ekstremizmit. Ai ka treguar se gjatë këtij viti pritet të fillojë ndërtimi i Xhamisë së Madhe në Prishtinë. Kryeimami Bajgora ka thënë se si çdo vit, edhe këtë herë për ta kryer Haxhin, në Mekë dhe në vendet e tjera të shenjta, janë të pranishëm edhe 1 080 besimtarë tanë nga Kosova

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINE, 19 GUSHT - Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Sabri Bajgora, ka treguar se kjo bashkësi fetare është e angazhuar maksimalisht për edukimin e drejtë të të rinjve dhe për mbajtjen e tyre larg nga mësimet ekstremiste. Ai ka deklaruar se kjo është një nga sfidat kryesore me të cilat po ballafaqohet BIK-u. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bajgora ka treguar për mbështetjen që kjo

bashkësi fetare ua ka dhënë institucioneve shtetërore për parandalimin e ekstremizmit dhe për rehabilitimin e deradikalizimit e të prekurve nga doktrinat ekstreme. "Sfidat e BIK-ut janë të shumta dhe të vazhdueshme por, fatmirësisht, kemi një kuadër jashtëzakonisht të aftë e të përgatitur për t'u ballafaquar me çdo sfidë. Këtu në radhë të parë e kam fjalën për kujdesin ndaj besimtarëve, posaçërisht ndaj të rinjve, që t'i mbrojmë ata të mos bien pre e mësimëve ekstremiste fetare. Në vitet e fundit jemi

angazhuar maksimalisht për çështjen e deradikalizimit", ka thënë Bajgora. Ai ka thënë se për ta mbrojtur rininë prej mësimëve ekstremiste duhet të ketë një qasje më të madhe nëpër ambiente të ndryshme. "BIK-u është i angazhuar maksimalisht për edukimin e drejtë të të rinjve tanë, në të njëjtën kohë t'i mbajë larg ata nga mësimet ekstremiste, mirëpo për këtë duhet pasur qasje më të madhe të rinjtë, si në sistemin shkollor, në media, në rrjetet sociale. Pastaj për këtë duhet edhe

kuadër i trajnuar enkas si dhe fonde, që nuk mund të sigurohen pa një koordinim e bashkëpunim me institucionet e vendit dhe institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë", është shprehur ai, duke shtuar se ruajtja e rinisë është obligim fetar dhe kombëtar.

Kryeimami Bajgora në këtë intervistë ka folur edhe për marrëveshjen e BIK-ut me Ministrinë e Drejtësisë, e cila parasheh ligjërimin nëpër burgje të imamëve të Kosovës kundër radikalizimit. Sipas tij, deri më tash kjo marrëveshje është duke u zbatuar në tri prej shtëpive korrektuese, ndërsa në javët në vazhdim do të fillojë gradualisht edhe në burgjet apo qendrat e tjera korrektuese anembanë Kosovës.

Sa i përket ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë, Bajgora ka thënë se kjo do të ndodhë gjatë këtij viti. "Me emër të Zotit ndërtimi i Xhamisë Qendrore do të nisë shumë shpejt. Shpresojmë se punimet të fillojnë gjatë këtij viti kalendarik.

Është një ekip teknik që po merret me detajet për fillimin sa më të shpejtë të punimeve. Fatmirësisht, edhe organet komunale kanë treguar gatishmërinë për lehtësim të procedurave, sepse Xhamia Qendrore do të jetë një objekt madhështor, me të cilin do të mburret kryeqyteti", është shprehur Bajgora.

**"Epoka e re":** Z. Bajgora, besimtarët e Kosovës që sivjet do ta kryejnë haxhin kanë mbërritur në Mekë. Sa është numri i haxhilerëve nga Kosova që e kanë marrë këtë rrugëtim dhe cila është gjendje e tyre?

**Bajgora:** Këto ditë besimtarët myslimanë nga e tërë bota kanë mbërritur në vendet e shenjta në Mekë e Medinë të Arabisë Saudite, të gatshëm që me përkushtim e devocion ta kryejnë një nga kushtet bazë të fesë islame, haxhin. Si çdo vit, edhe kësaj radhe, për ta kryer haxhin, në Mekë dhe në vendet e tjera të shenjta janë të pranishëm edhe 1 080 besimtarë tanë nga Kosova, përfshirë këtu udhëheqësit dhe ekipin mjekësor.

# Shkëmbime në luftimin e ekstremizmit

*Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Kur do të ndodhë fillimi i punimeve për ndërtimin e kësaj xhamie?*

**Bajgora:** Me emër të Zotit ndërtimi i Xhamisë Qendrore do të nisë shumë shpejt. Shpresojmë se punimet të fillojnë gjatë këtij viti kalendarik. Është një ekip teknik që po merret me detajet për fillimin sa më të shpejtë të punimeve. Fatmirësisht, edhe organet komunale kanë treguar gatishmërinë për lehtësim të procedurave, sepse Xhamia Qendrore do të jetë një objekt madhështor, me të cilin do të mburret edhe kryeqyteti.

**"Epoka e re":** *Cila janë sfidat me të cilat po përballët Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës?*

**Bajgora:** Sfidat e BIK-ut janë të shumta dhe të vazhdueshme por, fatmirësisht, kemi një kuadër jashtëzakonisht të aftë e të përgatitur për t'u ballafaquar me çdo sfidë. Këtu në radhë të parë e kam fjalën për kujdesin ndaj besimtarëve, posaçërisht ndaj të rinjve, që t'i mbrojmë ata të mos bien pre e mësimëve ekstremiste fetare. Në vitet e fundit jemi angazhuar maksimalisht për çështjen e deradikalizimit, pastaj për zgjidhjen e statusit juridik, sigurimin e bazës materiale për BIK-un etj.

**"Epoka e re":** *BIK-u më herët ka nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë, ku keni ofruar në dispozicion disa imamë për të ligjëruar nëpër burgjet e Kosovës kundër radikalizimit. A ka filluar të zbatohet kjo marrëveshje dhe çfarë ndikimi pritet të kenë këto ligjërata?*

**Bajgora:** Në maj të këtij viti BIK-u dhe MD-ja kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi, e cila parasheh që BIK-u të japë një kontribut edhe për të burgosurit nëpër burgjet e Kosovës, nëpërmjet ligjëratave dhe këshillave fetare. Kur jemi të kjo marrëveshje, më duhet ta bëj një sqarim për opinionin e gjerë, se marrëveshja në fjalë nuk konsiston që imamët të mbajnë ligjërata vetëdijësuese vetëm në fushën e deradikalizimit. Përkundrazi, kjo marrëveshje, e cila është marrë si shembull nga shumica e shteteve të BE-së dhe ShBA-së, në radhë të parë apo mbi 90 për qind u dedikohet kategorive të rëndomta të të burgosurve, të cilëve u lejohet të marrin këshillime fetare nëpër burgje, në përpjekje për ringritjen e tyre shpirtërore e morale, pas shkeljeve të ndryshme ligjore për të cilat edhe e vuajnë dënimin. Ndërkohë ligjërimi i imamëve për çështjen e

deradikalizimit është vetëm një segment i punës ekpore i një grupi ekspertësh, në të cilin përfshihen psikologë, sociologë, imamë, punonjës të arsimit, të shëndetësisë etj. Detyrë e këtij grupi është që nëse të dënuarit për çështje të radikalizimit fetar shprehin dëshirën të jenë pjesë e programeve për deradikalizim, atëherë ne së bashku me kolegët nga fushat e sipërtheksuara do të jemi të gatshëm ta japim kontributin tonë në formë të këshillimeve fetare dhe bisedave të hapura me ta, në mënyrë që t'i bindim se rruga që ata kanë ndjekur nuk është e drejta. E nëse ata nuk duan të jenë pjesë e këtyre programeve, atëherë askënd nuk mund ta detyrojmë me dhunë t'u nënshtrohet atyre. Dëshiroj ta vë në dijeni edhe opinionin e gjerë, se deri më tash kemi filluar punën në tri prej shtëpive korrektuese e në javët në vazhdim do të fillojmë edhe në burgjet apo qendrat e tjera kor-

rektuese anembanë Kosovës. Jam i bindur se çështja e ligjërimin të imamëve nëpër burgje do të jetë e suksesshme, sepse mendoj se besimtarët, pavarësisht cilit besim i takojnë, kanë të drejtë të marrin këshilla fetare. Unë besoj se shumë shpejt edhe bashkësitë e tjera fetare në vend do të jenë pjesë e këtyre programeve, të cilat do të udhëhiqen e menaxhohen nga Ministria e Drejtësisë, gjegjësisht Drejtoria e Burgjeve në nivel të Kosovës.

**"Epoka e re":** *Sa po arrin BIK-u që përmes mekanizmave që kanë dorë ta edukojë dhe përgatisë rininë që mos të bie pre e doktrinave ekstreme, të cilat sot janë problem në mbarë botën?*

**Bajgora:** BIK-u është i angazhuar maksimalisht për edukimin e drejtë të të rinjve tanë, në të njëjtën kohë t'i mbajë larg ata nga mësimet ekstremiste, mirëpo për këtë duhet pasur qasje më të madhe të rinjtë, si në sistemin shkol-

lor, në media, në rrjetet sociale. Pastaj për këtë duhet edhe kuadër i trajnuar enkas si dhe fonde që nuk mund të sigurohen pa një koordinim e bashkëpunim me institucionet e vendit dhe institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

BIK-u në vazhdimësi me institucionet e veta angazhohet që të rinjtë mos të bien pre e këtyre doktrinave të rrezikshme ekstremiste dhe në këtë drejtim kemi rezultate të prekshme. Ne kemi përkrahur e mbështetur institucionet tona qoftë në parandalimin e ekstremizmit, qoftë në rehabilitimin dhe deradikalizimin e të prekurve nga doktrinat ekstreme. Në brenda mundësive tona do të bëjmë atë që është e mundur, edhe pse deri më tash kemi bërë mjaft, por duhet angazhim edhe më i madh i të gjithë neve, i institucioneve përgjegjëse, që të ruajmë rininë tonë, sepse këtë e kemi obligim fetar e kombëtar.

## Për heronjtë



Vlora ÇITAKU

Ata nuk janë më. Shumë prej tyre i kam parë dhe u kam shkuar hap pas hapi gjatë viteve '98-'99 si gazetare e re. Njërin prej tyre e kam pasur dajë. Më të mirin. Ai ra më 7 gusht 1998. Plumbin e kishte marrë në ballë. Nuk ka vdeke më të mirë për një ushtar më patë thënë nëna. Ishte luftë dhe kurrë nuk e kemi qarë si duhet. Zaten, po e them me rrezikun të tingëllojë patetike, po as ai nuk e ka dashtë vajin kurrë. E mbaj mend si fëmijë mësimet e para për heronjtë i kam marrë nga ai. Mësimet e para për historinë i kam marrë nga ai. Historitë për Skënderbeun, Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën, Isë Boletinin e Shaban Polluzhën m'i tregonte teksa tymoste pafundësisht cigare. E ka pasur ves duhanin, po si me shaka gjithmonë thoshte se vdekjen nuk do ta ketë nga ai. I mbaj mend edhe bisedat që arrija t'i përgjoja si

fëmijë, të pëshpëritura në mes tije dhe nënës. Nuk ka liri pa luftë, thoshte gjithmonë duke kontestuar besimin apo më mirë thënë dëshirën e nënës për ta fituar lirinë pa luftë e pa humbje. Vetëm pasi na la, shokët e tij na treguan se ai kishte qenë që nga fillimi i përfshirë në luftën tonë, që nga faza e lëvizjeve klandestine. Pra, krejt ato që thoshte në netët e gjata pranë koftorit nuk ishin profeci, po besim, reflektim i asaj për të cilën ai punonte çdo ditë. Sot gruoja dhe fëmijët e tij jetojnë me një banesë të vogël në Prishtinë. Fill pas luftimeve, familjarët e tij, mblodhëm paratë për t'ua blerë një copë strehë gruas dhe fëmijëve të tij. Të jem e sinqertë, përderisa kam parë gruan e dajës të punojë çdo ditë për ta mbajtur familjen në atë banesë të vogël në Prishtinë, jo rrallëherë jam mllufosur me përdhosjen që po i bënin lirisë disa të tjerë që ishin turrë kah mbledhja e pamëshirshme e pasurisë. Në emër të luftës, normalisht. Kam parë disa të tjerë ta materializojnë luftën e tyre duke e kthyer në shtëpi, prona e para. Dhe kam parë shumë të tjerë që asnjëherë asgjë për luftën nuk kanë bërë, e më vonë kanë pasur gojën mbushur me

vetëlavdërim dhe të përfitojnë në emër të luftës së shenjtë. Por asgjë nga keqpërdorimet nuk barazohet me kulmin që u arrit këto ditë me regjistrimin e veteranëve të luftës. Regjistrimi paraqet relativizim të luftës dhe heroizmit të dajës tim dhe shokëve e shoqeve të tij që janë në amshim. Po, e vërtetë, të gjithë qytetarët e Kosovës janë hisedarë në lirinë dhe pavarësinë që gëzojmë sot. Po, secili prej nesh ka dhënë ndonjë kontribut që mund të konsiderohet si kontribut i pazëvendësueshëm. Prindërit e mi dhe kolegët e tyre që me dekada mësuari gjeneratat pa asnjë kompensim, mjekët që na shëruan plagët, artistët që na e mbajtën shpirtin gjallë, të gjithë, të gjithë pa përjashtim, janë hisedarë në lirinë që kemi sot. Ama jo të gjithë kemi qenë ushtarë me pushkë në dorë. Jo të gjithë kemi ofruar jetën në altar të lirisë. Gjithsesi, jo 50 000. Thjesht, kjo nuk është e vërtetë. Ligji për veteranët e UÇK-së nuk është ligji përmes të cilit nderohen gjeneratat dhe individët që historikisht kontribuan për liri. Ky ligj është vetëm për bashkëluftetarët e dajës tim, për ata që dhanë kontributin kulmor. T'ua ruajmë pak nderin dhe krenarinë.

**"Epoka e re":** *Ku do të mbahet ceremonia qendrore e faljes së namazit të Kurban Bajramit dhe cila është rëndësia e kësaj feste për besimtarët myslimanë?*

**Bajgora:** Manifestimi qendror për territorin e Kosovës do të mbahet në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, ndërsa rëndësia e kësaj feste për besimtarët është e veçantë, ngaqë kjo festë, pra Kuban Bajrami, ndërlidhet me haxhin ritual, me anë të të cilit dëshimohen përkushtimi, devocioni, barazia, sinqeriteti dhe çiltërsia ndaj krijuesit të gjithësisë. Po ashtu, kjo festë ndërlidhet edhe me prerjen (therjen) e Kurbanit, i cili bëhet vetëm për Zotin, por që në vete ngërthen solidaritetin, humanizmin dhe kujdesin ndaj atyre që kanë nevojë. Pra, në parim, festa e Kurban Bajramit manifeston përlulësinë, sakrificën dhe humanizmin.

**"Epoka e re":** *Që disa vjet besimtarëve myslimanë të Kosovës po u premtohet se shumë shpejt do të fillojë ndërtimi i*

# Dialogu rinis në pjesën e parë të shtatorit



Në pjesën e parë të muajit shtator do të mbahet takimi i radhës në kuadër të dialogut për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kështu ka bërë me dije presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, për gazetën "Epoka e re". Por, ai ka thënë se në këtë takim ende nuk është specifikuar se për çfarë do të diskutojë me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. I pari i vendit u ka bërë thirrje partive opozitare të bëhen pjesë e dialogut, duke thënë se bashkëngjitja e opozitës në këtë proces është e mirëseardhur. Megjithatë, Thaçi ka paralajmëruar se do ta vazhdojë fazën finale të dialogut edhe nëse opozita nuk bëhet pjesë e këtij procesi

Me rëndësi është të vazhdojë dialogu, të gjendet zgjidhja, të arrihet marrëveshja dhe Kosova të lëvizë drejt NATO-s dhe BE-së. Nuk do të humb kohë në asnjë rrethanë dhe për asnjë ditë për idetë lokale, projektet lokale apo hartat lokale. Ne duhet të shikojmë në hartën e madhe evropiane për arritjen e standardeve evropiane për Kosovën dhe Ballkanin. Pra, për një rajon pa kufi, i cili do të jetë i integruar në BE", është shprehur Thaçi, duke shtuar se do ta vazhdojë fazën finale të dialogut edhe nëse opozita nuk bëhet pjesë e këtij procesi.

Presidenti Thaçi ka qartësuar se askush nuk do të mund ta bllokojë këtë proces, i cili, sipas tij, garanton të ardhmen euroatlantike të shtetit të Kosovës. "Me rëndësi është që të gjithë bartësit e institucioneve të Kosovës kanë qenë të pranishëm në takimin e fundit në Bruksel. Shpresoj se edhe në takimin e radhës do të jenë. Ne do të punojmë të kemi një përfshirje sa më të gjerë të mundshme, mirëpo askujt nuk do t'ia imponojmë participimin në këtë proces. Pasi që procesi do të kalojë nëpërmjet referendumit, mendoj se secili ka

mundësi ta thotë fjalën e vet dhe nuk do të mund ta pengojë askush i vetëm këtë proces, kushdo që të jetë ai", ka deklaruar ai. Sipas presidentit Thaçi, nëse has në kundërshtim të subjekteve politike për këtë proces, marrëveshjen përfundimtare me Serbinë dhe çështjen e bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën do ta hedhë në referendum.

Për vazhdimin e dialogut ka folur edhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti. Ai ka thënë se Kosova duhet të jetë pjesë e këtij procesi, por në asnjë mënyrë të bëjë koncesione të cilat do të bartnin rrezikshmëri për funksionalitetin e shtetit. "Procesi i dialogut duhet të vazhdojë, duhet të ndiqet trendi i bazuar fund e krye në interesat kombëtare. Kosova nuk duhet të bëjë kompromise të reja sepse kompromiset e deritashme janë tregues shumë i qartë se Kosova ka zbatuar standardet më të larta për respektimin e të drejtave të komuniteteve. Kosova duhet të jetë pjesë e dialogut, por në asnjë mënyrë të bëjë koncesione të tjera të cilat do të bartnin rrezikshmëri për funksionalitetin e shtetit", ka deklaruar

Hoti në një intervistë për gazetën "Epoka e re".

Ai ka vlerësuar se mungesa e konsensusit lidhur me këtë çështje është për keqardhje. Por, sipas tij, më e rëndësishme është se çfarë flitet dhe çfarë vendimesh merren në kuadër të dialogut sesa kush e udhëheq këtë proces. "Mungesa e konsensusit politik në Kosovë është për keqardhje. Kjo nuk është diçka e re sepse pothuajse asnjëherë për çaste të ndjeshme nuk kemi pasur konsensus. Megjithatë, konsensusi më i madh i të gjitha partive në pushtet dhe atyre opozitare është Kushtetua e Republikës së Kosovës. Çdo gjë që bëhet në kuadër të respektimit të Kushtetutës dhe të rendit do ta ketë përkrahjen e njërës, respektivisht të këndit tjetër. Idetë e tjera të cilat kanë sjellë divergjenca pozitive-opozitive, madje edhe pakënaqësi të miqtë ndërkombëtarë, përfundimisht duhet të braktisen. Nuk është shumë i rëndësishëm fakti se kush e udhëheq procesin e dialogut me Serbinë, mirëpo ka shumë rëndësi se çfarë bisedohet dhe çfarë vendime merren në këtë proces", është shprehur Hoti.

**EPOKA E RE****Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 19 GUSHT** - Ndonëse në shtator është paraparë vazhdimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ende nuk dihen temat për të cilat do të diskutojnë dy presidentët. Sidoqoftë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se takimi i radhës pritet të mbahet në pjesën e parë të shtatorit dhe, sipas tij, ky takim do të jetë i menduar për të filluar me një bazë të diskutimit për të ardhmen. "Shpresoj në pjesën e

parë të shtatorit. Ende nuk është specifikuar se çka. Dy takimet e para më tepër kanë qenë procedurale dhe teknike. Besoj se takimi i radhës do të jetë i menduar për të filluar me një bazë të diskutimit për të ardhmen", ka deklaruar Thaçi në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re". I pari i vendit u ka bërë thirrje partive opozitare të bëhen pjesë e dialogut duke thënë se bashkëngjitja e opozitës në këtë proces është e mirëseardhur. "Ftesa gjithmonë është e hapur. Bashkëngjitja e opozitës në këtë proces është e mirëseardhur.

Bekim Jashari ofron dokumente zyrtare që tregojnë se komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari, ka lindur më 28 nëntor të vitit 1955

# Përgënjeshtrohen me fakte pretendimet se datëlindja e Adem Jasharit ishte falsifikuar

Nipi i Adem Jasharit, Bekim Jashari, i cili është kryetar i Komunës së Skenderajt, ka ofruar dokumente zyrtare që dëshmojnë se komandanti legjendar i UÇK-së ka lindur më 28 nëntor 1955. Në këtë mënyrë, duke prezantuar certifikatën e vdekjes dhe librin amëz, në të cilin janë të dhënat zyrtare me data të lindjes dhe vdekjes së dëshmorëve, Bekim Jashari ka përgënjeshtuar pretendimet e analistit politik Nexhmedin Spahiut, i cili ka thënë se Adem Jashari ka lindur më 10 tetor e jo më 28 nëntor të vitit 1955



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**SKENDERAJ, 19 GUSHT** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i ka demantuar me fakte pretendimet e ngritura për falsifikimin e ditëlindjes së komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari. Fillimisht Bekim Jashari ka publikuar certifikatën e vdekjes së axhës së tij, duke dëshmuar të kundërtën e asaj që ka thënë analisti Nexhmedin Spahiut rreth ndryshimit të datëlindjes së

komandantit. Në këtë dokument shkruan se Adem Jashari është i lindur më 28 nëntor 1955 dhe jo siç ka deklaruar Spahiut, se ka gjetur nëpër arkiva që komandanti i UÇK-së ka qenë i lindur më 10 tetor të të njëjtit vit. "Na qenka lajmëruar z. Nexhmedin Spahiut?! Ai mund të jetë gjithçka në jetë, profesor, doktor shkence, i arrirë, por kurrë gazetar. Profesionin, për të cilin ai luftoi tërë jetën për të përvetësuar, e që nuk ia doli, për fat të tij të keq, do ta kishte detyruar t'u bindej fakteve të preksime e të gjalla. Gazetarët, me fjalë të tjera,

merren me fakte, e jo me 'gojëdhëna'", ka shkruar Bekim Jashari në profilin e vet në "Facebook". I pari i Skenderajt nuk është ndalur

me kaq. Ai sërish në një postim të dytë në profilin e vet në "Facebook" ka prezantuar edhe librin amëz, në të cilin janë të dhënat zyrtare me data të lindjes dhe vdekjes së dëshmorëve dhe civilëve të tjerë. "Kapakun po ia vëmë me shënime, më zyrtare të mundshme të Gjendjes Civile në Prekaz të Epërm, referuar librit amëz, në të cilin janë të dhënat zyrtare me data të lindjes dhe vdekjes së dëshmorëve dhe civilëve të tjerë. Sa për informatë, librat amëz janë kopje e originalit që i kishte marrë Serbia dhe, sipas ofiqarit në Prekaz, origjinali ndodhet në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës", ka shkruar Jashari.

mentet në gjuhën serbe). Fakte të tjera që dëshmojnë atë që dihet tashmë botërisht, e të cilën e kam paraqitur më parë, nuk ka. Të tillët e sojit të Nexhmiut mund të kenë, por ato nuk janë fakte, por janë qëllime të rrezikshme", ka shkruar Bekim Jashari.

Faktet e prezantuara nga nipi i komandantit të UÇK-së konfirmohen edhe nga Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 11. 7. 1997, ku shkruan se Adem Jashari është i lindur më 28. 11. 1955.

Një ditë më parë analisti Nexhmedin Spahiut kishte ngritur dyshime se ditëlindja e komandantit të UÇK-së ishte falsifikuar. "Kush është ai që i falsifikoi ditëlindjen Adem Jasharit. Nga 10.10.1955 e bëri 28.11.1955! Duhet me u hi gazetave mbas 1998-s për të gjetur se kush është ai falsifikator i rrezikshëm dhe për ta dënuar. Sa më vjen inat që edhe vetë e kam hëngër këtë mashtrim të paskrupullit, e kam përdorur në një shkrim timin. Nuk më shkonte mendja se dikush ka nevojë për të gënjyer publikisht aq paskrupullit", ka shkruar Nexhmedin Spahiut në profilin e vet në "Facebook".

UNITED NATIONS United Nations Interim Administrative Mission in Kosovo		NATIONS UNIES Mission d'Administration Interimaire des Nations Unies au Kosovo	
LIBRI AMËZ I TË VDEKURVE		MATIČNA KNJIGA UMRLIH	
Ordinal number: Numri rendor Tekući broj	65.	Date of death: (Day, month, year and hour of death) (Dita, mesi, godina i čas smrti)	07-03-1998.
Name, surname and sex of dead person Ime, prezime, pol i prezime Mëmiri para martesës Prezime për shtetësiarë bashkuar	Adem Jashari M.	Place of death and address (Vendi i vdekjes dhe adresa)	Prekazi i Ujtë.
Surname before marriage Mëmiri para martesës Prezime për shtetësiarë bashkuar	Jashari	Cause of death Shaku i vdekjes Lidhja	Shënimet dhe shënime të shtetësiarë bashkuar Zënjës Informacion Skenderaj Nr. 799/01. 01-11-2001. Pa mjaftencat Serbe në Prekaz të Ujtë - Spahiut
Date of birth of dead person Datëlindja e të vdekurit Datum rođenja umrlog	28-11-1955.	Subsequent changes and notes, objections Registritimi i mëvonshme dhe shënime, vërejtjet Nakonak opisi i pobjedak, primolje	
Place and municipality of birth Vendi dhe komuna e lindjes Mesto i rođenja urodinje	Prekazi i Ujtë - Skenderaj		
ID number Numri Amëz Matični broj			
Citizenship Shtetësiarë Državljanstvo			
Address of residence Vendbanimi dhe adresa Prevalitë i adresa	Prekazi i Ujtë - Skenderaj		
Marital status Gendja bashkëshortore Bračno stanje	J martuar		
Name and surname of marital partner Ime dhe prezime bashkëshortorësh Ime i prezime bračnog druga	Adite Jashari Gama		
Surname of marital partner before marriage Mëmiri i bashkëshortorësh para lindjes së martesës Prezime bračnog druga per zaključnja braka			
Name and surname of parents Ime dhe prezime prindërve Ime i prezime roditelja	Shaban Jashari Zaha Jashari - Gea		
Name of informant of death Paraqitësi i vdekjes Prijavitelj smrti	Bekim Jashari		
Informant's address of residence Adresa e paraqitësit Prevalitë prijavioaca	Prekazi i Ujtë - Skenderaj		
(Signature of informant) Nënshkrimi i paraqitësit Potpis prijavitelja	Bekim Jashari		
Date of registration Data e regjistritimi Datum upisa	02-11-2001.		
		Signature of registrar Nënshkrimi i regjistrit Potpis matičara	

## LV-ja akuzon policinë për dhunë ndaj aktivistëve të arrestuar

**PRISHTINË, 19 GUSHT (ER)** - Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Saranda Bogujevci, e cila ishte arrestuar bashkë me disa aktiviste të kësaj lëvizjeje më 17 gusht në aksionin kundër dhunës ndaj grave që u mbajt në Prishtinë, ka mbajtur të diellën konferencë për medie. Në konferencë folën edhe aktivistet Rinë Zhitia, Arta Berisha, Elona Kurti dhe Diellëz Arifi. Aktivistja e Lëvizjes Vetëvendosje, Rinë Zhitia, ka thënë se gratë po

vriten çdo ditë kurse Policia e Kosovës nuk po merr masa, duke shërbyer vetëm si mjet justifikues për ta. Sipas saj, Policia e Kosovës është duke trajtuar dhunën ndaj grave si diçka të mbyllur dhe private. Gjithashtu, aktivistja tjetër Arta Berisha ka thënë se Policia e Kosovës ka ushtruar dhunë ndaj aktivistëve të Vetëvendosjes, Çlirim Gerbeshi dhe Atdhe Arifi, të cilët u arrestuan më 10 gusht pasi kishin hedhur ngjyrë të kuqe në

protestën kundër ndaljes së dhunës ndaj grave. Ajo ka thënë se ngjyra e kuqe është hedhur vetëm në institucion dhe në asnjë moment nuk është sulmuar asnjë zyrtar policor. Ndërsa deputetja nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Saranda Bogujevci, ka pohuar se megjithëse u është ofruar ndihmë, ka qenë e vështirë të marrin ndihmë në atë çast. Ajo pati edhe një lutje, që çdo ditë të ngrihet zëri i grave, që të flitet e të protestohet,



që të ndalet dhuna ndaj grave. Sipas Bogujevcit, Kosova është një

vend i vogël me numër të madh të grave që po keqtrajtohen.

Intervistë me drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Blerim Pushkolli

# Të hyrat nga policat e sigurime



Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Blerim Pushkolli, ka thënë se të hyrat nga premitë e sigurimit kufitar për periudhën janar - qershor të këtij viti janë në vlerë prej 2,421,556 eurosh (pa TVSh). Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ai ka folur edhe për anëtarësimin e BKS-së në Këshillin e Byrove. Ai ka theksuar se BKS-ja ka dorëzuar aplikacionin për anëtarësim në Këshillin e Byrove në vitin 2011. Pushkolli ka thënë se mosanëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara është barrierë kryesore që kërkon qasje serioze për ta bërë të mundur anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrove

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 GUSHT -

"Epoka e re": Z. Pushkolli, meqenëse Austria ka refuzuar mbulimin me kartonin e gjelbër, a mund të kërkojë asistim gjetkë? Pushkolli: Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) nuk do të ndalet në këtë drejtim derisa ta zgjidhë këtë çështje, edhe përkundër refuzimit në këtë rast të Austrisë. Gjithashtu, nuk do të mungojë

vazhdimësia, as nuk ka munguar asnjëherë, pasi kur Këshilli i Byrove kishte kërkuar që Kosova t'i plotësonte disa parakushte para se t'i fillojë procedurat e aplikimit të saj në Këshillin e Byrove në Bruksel, që atëherë ishte vepruar në procedim të çështjes në mënyrë institucionale, duke plotësuar kushtet si vijojnë: Aproximin e Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Themelimin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve

dhe Qendrës Informativë të Sigurimeve, si dhe Fondin Garantues, në shumë prej katër milionë eurosh. Bazuar në këtë, kushtet e kërkuara nga Këshilli i Byrove, BKS-ja i ka plotësuar dhe ka dorëzuar aplikacionin për anëtarësim në Këshillin e Byrove në vitin 2011. Pos të tjerash, mosanëtarësimi në OKB është barrierë kryesore, e cila kërkon qasje serioze për të bërë të mundur më pas anëtarësimin e Kosovës për në Këshillin e Byrove. Sa i përket

refuzimit të austriakëve, vlen të theksohet se Shoqata e Austrisë në përgjithësi mbështet përfshirjen e Kosovës për anëtarësim në sistemin e Kartonit të Gjelbër mirëpo, për të marrë përsipër mbulueshmërinë territoriale të Kosovës, e ka konsideruar si rrezik financiar për anëtarët e vet.

**"Epoka e re":** Pos pranimit në OKB, mund të jetë shkak edhe numri i lartë i automjeteve të pasiguruar?

Pushkolli: Po, numri i lartë i automjeteve të pasiguruar paraqitet si imazh jo i mirë, e veçmas nga kjo shkelje e ligjit shkaktohen dëme shumë të mëdha, respektivisht edhe humbje të tjera që ndërlihen. Automjeti i paregjistruar, siguruar, konsiston se nuk ka kontroll teknik, paraqet rrezik të lartë për sigurinë në

trafik, po ashtu nga kjo rezulton se buxheti i Kosovës humbet financiarisht nga mosinkasimi i tatimeve dhe taksave të regjistrimit nga sigurimi i këtyre automjeteve, njëkohësisht kompanitë e sigurimit janë të penalizuara dyfish pasi, pos mungesës të të hyrave nga sigurimi, obligohen t'i kompensojnë palët e treta, viktima në aksidente të cilat shkaktohen nga këto automjete. Gjithashtu, edhe disa vendime të dala nga MPB-ja, komuna dhe institucione të ndryshme ndikojnë në mënyrë direkte apo indirekte në rritjen e numrit të automjeteve të pasiguruar, pasi po bëjnë ndërlihdjen e inkasimeve të ndryshme tatimore, shërbimeve publike, duke i lidhur me regjistrimin e automjeteve, p. sh., pagesën e gjobave të trafikut, pagesën e tatimit në pronë dhe të



# ve arrijnë mbi dy milionë euro

shërbimeve komunale në disa komuna, zgjatjen e afatit për regjistrimin e veturave etj. Kjo e fundit mund të ketë efekt në formë kampanje për disa muaj, por jo në afat të pacaktuar. Pastaj këto vendime po ndikojnë te qytetarët dhe po zvarritet procedura e regjistrimit të automjetit. Institucionet publike do të duhen të gjejnë medoemos mekanizma të tjerë për inkasim të të hyrave ndaj institucioneve të tyre. Është shumë i nevojshëm koordinimi ndërinstytucional lidhur me këto çështje. Zgjidhje të këtij problemi mund të ketë duke aplikuar praktika nga vendet e ndryshme që kanë efekt të lartë: konfiskimi i menjëhershëm i automjetit nëse gjendet i pasiguarur në vend publik, si dhe largimi nga puna kur policët gjenden në trafik me automjetet e pasiguruara.

**"Epoka e re":** Me një numër kaq të lartë të automjeteve të pasiguruara, siç thoni ju, rrezikojmë mos të jemi pjesë e kartonit të gjelbër apo lëvizjes së lirë të automjeteve edhe pas anëtarësimit në Këshillin e Byrove?

**Pushkoll:** Nga Këshilli i Byrove do të vlerësohet numri i ulët i automjeteve sepse është parakusht teknik, i cili duhet të jetë i përmbushur edhe pas pranimit në Këshillin e Byrove. Nisur nga kjo, duhet pasur parasysh se veturat e paregjistruara nuk duhet të shikohen vetëm si kërkesë nga Këshilli i Byrove, por për arsye se pronarët/drejtesit e automjeteve të pasiguarur janë shkakuar të shumë aksidenteve që përfundojnë jo vetëm me dëme të mëdha materiale, por edhe me fatalitet. Numri i të vdekurve, në këtë rast nga aksidentet e shkaktuara prej të pasiguaruarve që nga themelimi i Fondit

të Kompensimit, ka arritur në 195.

**"Epoka e re":** Nisma e Komisionit për Buxhet dhe Financa për të kërkuar nga Austria mbulim për kartonin e gjelbër është komentuar si interferim politik. Kemi të bëjmë me çështje politike apo çështje byrosh?

**Pushkoll:** Në radhë të parë rolin kryesor ndaj çdo kontakti duhet ta ketë BKS-ja, si e vetnija me autorizime publike në këtë lëmë, të cilat janë të instaluar me Ligjin 04/L-018 si dhe në harmoni me Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Byrove. Nisur nga kjo dhe dokumentet e ndryshme të Këshillit të Byrove decidivisht ceket se Byrotë Nationale duhet të jenë të pavarura. Pra, Byroja është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit të gjelbër, dhe se diskutimet teknike lidhur me këto çështje të sigurimeve do të duhej të bëheshin vetëm nga përfaqësuesit të cilët janë të përcaktuar me ligj dhe bashkërisht me ekspertët e këtij lëmi për industrinë e sigurimit, ndonëse mungesa e njohurive nga institucionet e tjera jo vetëm se nuk preferohet, por mund të paraqesë ndonjë dështim në procedimin e çështjeve siç kërkohet përkatësisht nga Këshilli i Byrove. Nga institucionet tona shtetërore kemi nevojë vetëm për mbështetje politike jashtë vendit, e jo të bartet kjo çështje si interferim politik.

**"Epoka e re":** Sa është shuma që kanë paguar bashkatdhetarëve për policat e sigurimeve gjatë këtij sezoni?

**Pushkoll:** Të hyrat nga primet e sigurimit kufitar për periudhën janar - qershor 2018 janë në vlerë

prej 2,421,556 eurosh (pa TVSh). Pagesa e dëmeve të paguara nga BKS-ja për periudhën janar - qershor 2018 kap vlerën 2,691,563 euro. Shpenzimet për këtë periudhë kanë qenë rreth 916,621 euro. Gjithsej, në total dëme dhe shpenzime të tjera vlera ka qenë 3,608,184 euro. Sa për sqarim, aplikimi i policës kufitare është bërë për arsye se kompanitë e huaja të sigurimit në EU dhe jashtë saj e përjashtojnë Kosovën nga mbulesa e tyre e sigurimit, duke pasur parasysh se Republika e Kosovës nuk është anëtare e Këshillit të Byrove të Kartonit të Gjelbër dhe duke u bazuar në Nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

**"Epoka e re":** Dëmet nga automjetet e pasiguarur që paguhen nga Fondi i Kompensimit kapin shifrën mbi 27 milionë euro. Si grumbullohen këto mjete në Fondin e Kompensimit?

**Pushkoll:** Për periudhën 2010-2017 dëmet të cilat janë paguar nga Fondi i Kompensimit kapin shumën 27.8 milionë euro. Kompanitë e sigurimit të cilat ushtrojnë veprimtari në sigurimin e detyrueshëm në territorin e Republikës së Kosovës janë të detyruara të kontribuojnë financiarisht në këtë fond konform Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, respektivisht Kreu IV, Neni 32, Paragrafi 2. Gjithashtu, përveç ndikimit negativ financiar në sektorin privat, respektivisht industrinë e sigurimeve, në masë të njëjtë kjo ndikon edhe buxhetin e shtetit për shkak të mosinkasimit të tatimeve dhe taksave të ndryshme gjatë regjistrimit të automjeteve.

## Bankat u marrin bizneseve pesë për qind tarifë për deponimin e parave metalike

PRISHTINË, 19 GUSHT - Bankat komerciale në Kosovë sa shkojnë e rrisin barrën ndaj bizneseve, duke përdorur norma të larta për shërbime. Vetëm për deponimin e parave të imta (metalike) tarifa është 5 për qind e shumës deponuese. Kjo për bizneset dhe ekspertët të ekonomisë po konsiderohet plaçkitje, e cila nuk duhet lejuar të ndodhë. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) nuk komenton këtë çështje, ndërkohë Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

thotë se BQK-ja është i vetmi rregullator për bankat. Pronari i furrës së bukës "Doni" në Prishtinë, Avni Lushaj, gjatë ditës punon thujse vetëm me para të imëta, e kur ato shkon t'i deponojë në bankë, kjo e fundit po ia merr fitimin. Kështu ka deklaruar ai për "KosovaPress", duke shpjeguar se për një mijë euro deponim, banka ia merr 50 euro që, sipas tij, i gjithë fitimi i mbetet aty. Ai kërkon që kjo përqindje të hiqet fare, e nëse kjo nuk

ndodh, të paktën të ulët në 2 për qind, nga 5 për qind sa është aktualisht. Profesori në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, Nagip Skenderi, ka pohuar të jetë i njoftuar për këtë veprim, siç e quan ai, jo të drejtë që e bëjnë bankat komerciale me këtë normë shumë të lartë. Edhe analisti i ekonomisë, Jakup Bellaqa, ka deklaruar se kjo tarifë prej pesë përlindësh nuk është normale dhe ky veprim është i papranueshëm.



Dëshirat më të bukura  
për më të dashurit



*Me fat  
Kurban Bajrami*



Instagram/abi.center / Facebook/abicenter1



— URIME —  
**KURBAN BAJRAMI**



WWW.VIPA-KS.COM





## Policia zvogëlon numrin e dënimeve në trafik

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Të dhënat e fundit të publikuara nga Policia e Kosovës tregojnë për ulje të madhe të numrit të tiktave të shqiptuara nga policia. Në raportin e fundit policia ka raportuar për vetëm 1 198 tiktave të shqiptuara.

Dy javë më parë numri i tiktave shkonte deri në 1 850 në ditë në kohën kur aksidentet ishin shpeshtuar. Duke iu refer-

uar situatës aktuale lidhur me aksidentet në trafik dhe pasojat e tyre, Ministria e Punëve të Brendshme përmes Policisë së Kosovës pati ndërmarrë masa serioze shtesë, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë, parandalimin e aksidenteve të trafikut dhe zbatimin e ligshmerisë në funksion të menaxhimit dhe kontrollit të trafikut rrugor.

Për këtë qëllim Policia e Kosovës nga data 24 korrik pati themeluar task forcë për parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor. Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, në periudhën janar - qershor të këtij viti 60 persona kanë humbur jetën si pasojë e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe 5 629 persona janë lënduar lehtë dhe rëndë.

# Berisha dhe Bahtiri kundër ndarjes së Kosovës

TIRANË, 19 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, është takuar në Tiranë me ish-kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha, me të cilin ka biseduar për situatën në Mitrovicë dhe për zhvillimet e fundit në vend.

Në deklaratën e bërë pas takimit, politikani i njohur shqiptar Sali Berisha ka thënë se ishte kënaqësi e veçantë për ta takuar kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, që ka bërë përpjekje të jashtëzakonshme dhe ka dhënë kontribut thelbësor për ta bërë Mitrovicën një komunë të zhvilluar dhe të prosperueshme për të gjithë qytetarët e saj, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Ai ka shprehur admirimin e tij për atë që Bahtiri ka bërë për Mitrovicën dhe për zhvillimin e saj. "Të dy jemi kategorikë se integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i paprekshëm dhe i shenjtë për të gjithë shqiptarët. Është mjerim i madh të shikosh se si Vuçiqi idenë e tij e të Serbisë për gllabërimin territorit të Kosovës po e shet tek njerëz të caktuar në Prishtinë, edhe pse të gjithë shqiptarët e dinë, por edhe të tjerët, se Serbia nuk ka në Kosovë as edhe një metër tokë të vetën", ka thënë Berisha. Sipas tij, kufijtë aktualë të Kosovës të njohur ndërkombëtarisht janë sanksionuar me aktin e shpalljes së pavarësisë së saj, me pakon e



presidentit Ahtisari, me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, me njohjen nga ana e 115 shteteve të botës, prandaj askush nuk ka të drejtë, nuk mund dhe nuk guxon t'i nëpërkëmbë këta kufij për qëllime përfituese të Serbisë. "Agim Bahtiri gjykon se Mitrovica e Veriut është peng e bandave kriminale të telekomanduara nga

Serbia. Unë ndaj me Agimin shqetësimin e tij të thellë për zhvillimet e fundit. Uroj që Agimi dhe faktorët e tjerë politikë në Kosovë t'u japin përgjigjen e duhur serbëve e Beogradit dhe argatëve të tyre në Kosovë, se nuk duhet të ketë tjetërsim të territorit të Kosovës", ka thënë Berisha. Po ashtu, Berisha ka shtuar se nuk është interes i

shqiptarëve dhe as interes i qytetarëve të Ballkanit të hapet "kutia e Pandorës", që të ridizajnohen kufijtë, sepse atëherë pasojat do të ishin të rënda për të gjithë. Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, pasi ka falënderuar ish-kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha, për pritjen e ngrohtë dhe bisedën shumë të frytshme, ka thënë se angazhimi i Berishës

lidhur me zhvillimet e fundit lidhur me Kosovën është kontribut për paqe në Ballkan. "Z. Berisha është fuqimisht i përkushtuar për paqe në Kosovë dhe në Ballkan. Unë e falënderoj shumë për mbështetjen që më dha dhe për interesimin e tij të vazhdueshëm për Mitrovicën, Kosovën dhe çështjen kombëtare", ka deklaruar Bahtiri.

## Beqiri: Prej 940 personave me sindromën Down, gjashtë janë të punësuar



PRISHTINË, 19 GUSHT - Organizata "Down Sindrom Kosova" ka arritur që përmes programeve që i aplikon t'i aftësojë për punë shumë persona. Sebahate Beqiri ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se vetëm gjashtë persona me sindromën Down janë punësuar. Ajo ka theksuar se mungon përkrahja institucionale e duhur dhe se në vitin 2016 është marrë iniciativë për hartimin e ligjit gjithëpërfshirës, ligj ky që do t'i trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë

personat me aftësi të kufizuara. Por, kjo shoqatë ende vazhdon të presë që Qeveria e Kosovës ta miratojë këtë koncept-dokument për t'i hapur rrugë draftimit të projektligjit për këtë grup të shoqërisë. "Në bazë të statistikave që kemi si shoqatë kemi rreth 940 persona të regjistruar, por ky numër mund të ndryshojë sepse në vazhdimësi kemi raste të moshës madhore që për arsye të ndryshme nuk kanë kontaktuar shoqatën. Gjithashtu, përcjellim

edhe lindjet e foshnjave me sindromën Down, duke u bazuar në bashkëpunimin që kemi me laboratorin e gjenetikës brenda klinikës së gjinekologjisë në Prishtinë. Çdo foshnje që diagnostikohet me sindromën Down atëherë aty plotësohet një formular i shoqatës ku ne marrim të dhëna për numrin e lindjeve për foshnjat me këtë sindromë. Por, kemi raste që nuk kanë qenë të lajmëruar më herët në shoqatë apo në institucione të tjera", ka thënë Beqiri.

*Me Fat  
Kurban Bajrami!*



**PRISHTINA  
INTERNATIONAL  
AIRPORT  
ADEM JASHARI**

**Limak  
KOSOVO**

**KEDS** **KES|CO**



*Me Fat  
Kurban Bajrami*

# Me fat Kurban Bajrami!

IPKO ju uron të gjithë besimtarëve musliman  
festën e shenjtë të Kurban Bajramit!



## Familja Kaçkini në Skenderaj bëhet me shtëpi të re

SKENDERAJ, 19 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, bashkë me hoxhën Halil Kastrati dhe Megzon Hotin, i cili ka financuar tërë ndërtimin e shtëpisë së familjes Kaçkini, ua

kanë dorëzuar kësaj familje çelësat e shtëpisë së re. Bekim Jashari ka thënë se donatorët meritojnë të vlerësohen për këto vepra fisnike. "Shoqata 'Jetimat e Ballkanit', e udhëhequr nga hoxha i nderuar, z.

Halil Kastrati, ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në komunën tonë, në zbutjen e gjendjes së të pastrehëve, duke iu ndërtuar shtëpi të re banimi. Përfitoj nga rasti t'u bëj apel të

gjithë njerëzve vullnetmirë, kompanive, firmave, dyqaneve dhe të tjerëve, ta ndjekin këtë shembull për t'i ndihmuar ata që janë në nevojë", është shprehur kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari.



## Sot dihen dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet në Therandë

Therandë, 19 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije të dielën se janë duke u punuar në nxjerrjen e të dhënave, ku qytetarët kanë dërguar formularët dhe fotografitë me të dhënat e tyre nga dëmet në vërshimet e fundit në këtë komunë. "Po punohet intensivisht për nxjerrjen e të dhënave, ku qytetarët kanë dërguar formularët dhe fotografitë me të dhënat e tyre nga dëmet në vërshimet e fundit", ka thënë ai.

Muharremaj ka thënë se për këto të dhëna do të raportohet

sot (e hënë) para Asamblesë Komonale, kurse pas këtij raportimi përfaqësuesit Qeverisë së Kosovës do ta vizitojnë Komunën e Therandës. Kryetari Muharremaj në një intervistë për gazetën "Epoka e re" ka pohuar se dëmet nga vërshimet e fundit në këtë komunë parashihen të jenë miliona euro. "Dëmet janë të mëdha dhe, sipas të dhënave të cilat ende po i mbledhim, arrijnë shifra milionëshe në infrastrukturë dhe amvisëri. Janë dëmtuar rrugë, hapësira bujqësore dhe katet përdhës të shtëpive", ka thënë Muharremaj.



## Bëhen përgatitjet për 'Hardh Fest'



RAHOVEC, 19 GUSHT (ER) - "Hardh Fest" po vjen unik dhe promovues si gjithmonë. Një nga emrat e shumë ndërkombëtarë dhe vendorë që këtë vit do të performojnë "Me pamje kah vneshta" në "Hardh Fest" është super ylli i muzikës Progressive House nga Amsterdami, NOUVEABEATS.

I njohur ndërkombëtarisht, NOUVEABEATS ka performuar në skena të mëdha të muzikës si në Belgjikë, Francë, Spanjë, Angli, Greqi, Suedi, Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, me yje të njohur si Afrojack, Arty, Bassjacks, Bingo Players, Carnage, Chuckie, Don Diablo, Dubvision, DVBS, Firebeatz, Hardwell, Helena, Laidback Luke, Nicky Romero, James & Ryan Marciano etj.

Në skenën e madhe n'Konak të "Hardh Fest 2018" do të jetë një nga emrat kryesor të edicionit të XVII të këtij brendi që tashmë është një nga festat më të mëdha dhe më origjinale në vend. Në ditët në vazhdim "Hardh

Fest" do t'i publikojë edhe emrat e artistëve të tjerë ndërkombëtarë dhe vendorë, të cilët kanë lënë gjurmë në industrinë e muzikës.

Komuna e Rahovecit ka bërë me dije se hyrja në koncert do të jetë pa pagesë.

Këtë vit, datat 7, 8 dhe 9 shtator janë të rezervuara për "Hardh Fest 2018", që organizohet nën përkujdesjen e kryetarit të komunës, Smajl Latifi, si dhe partnerit të festivalit "Stone Castle".

## Haziri bën thirrje të ndihmohen qytetarët në nevojë

GJILAN, 19 GUSHT (ER) - Në Komunën e Gjilanit të dielën ka filluar aktiviteti i madh humanitar "Dhuro... bëje të lumtur dikë", me qëllim që t'u dalët në ndihmë sado pak qytetarëve në nevojë.

Kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, ka bërë thirrje për t'iu bashkangjitur këtij aktiviteti te Sheshi "Agim Ramadani". "Deri tani qytetarët, Këshilli i Bashkësisë Islame dhe kompania 'Durrësi' kanë dhuruar më shumë se dy tonë veshmbathje për mosha të ndryshme, të cilët i falënderoj shumë. Apeloj që mbështetja për njerëzit në nevojë të vazhdoj", ka thënë Haziri.

Ai ka shtuar se me këtë aktivitet Gjilani po del të jetë qendra më e madhe administrative më



sociale në Ballkanin Perëndimor. "Përveç kësaj, i kemi ndërtuar 65 shtëpi për familjet me gjendje të rëndë sociale, i kemi rinovuar 40 shtëpi dhe për 40 familje të tjera po paguajmë qira. Nuk duhet harruar edhe mbrëmjen humanitare për mbështetje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, prej së cilës kanë përfutur organizatat që i trajtojnë këto raste. Jam krenar me solidaritetin e njerëzve të vullnetit të mirë", ka thënë Haziri.


## Premtohet zgjidhje për çështjen e furnizimit me ujë në Fushë-Kosovë

FUSHË KOSOVË, 19 GUSHT (ER) - Shumë shpejt qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës do të kenë furnizim me ujë të pijshëm 24 orë në ditë, pasi që ministri Hamza ka arritur pajtueshmërinë ndërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe KRU "Prishtina" përmes propozimeve konkrete për ta

amendamentuar marrëveshjen e projektit nga Faza e III e projektit për ndërtimin e fabrikës për ujë të pijshëm në Shkabaj. Sipas kësaj pajtueshmërie, mjetet e mbetura në projekt të përdoren për furnizimin me ujë për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe përmirësimin e mëtutjeshëm të

furnizimit me ujë për qytetarët e Komunës së Prishtinës. Ministri Hamza, pas një angazhimi të madh, ka mundur zgjidhjen e këtij problemi shumëvjeçar dhe shumë të rëndësishëm për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës. Përveç këtij investimi, me këtë amendamentim parashihen edhe

investime të tjera për Komunën e Prishtinës, siç janë: Vendosija e pompës shtytëse nga Stacioni i Pompave Mirdita II në Rezervuarin Mirdita III në Matçan; Rehabilitimi i rrjetit (zëvendësimi i rrjetit të vjetër me rrjetin e ri) të ujësjetës në Bregun e Diellit - Zona Qendër dhe Zona e Perëndimit në Prishtinë;



dhe Rehabilitimi i rrjetit (zëvendësimi i rrjetit të vjetër me rrjetin e ri) të ujësjetës në Lagjen e Medresesë në Prishtinë.

*Me fat  
Kurban Bajrami*



# ME FOL - SERM, MOS ME FOL - DUKAT



**Shkruan: Jakup KRASNIQI**

Populli ynë shumë shekuj historie i kapërceu me ndalesa shkolle e arsimimi shqip, por me kujtesë e mbamendje të madhe la trashëgim një filozofi me porosi të shumta edukative, filozofi që reflekton kulturë të nivelit të lartë empirie jetësore, së cilës ne sot duhet t'ia kemi zili. T'ia kanë zili, madje edhe njerëzit më të arsimuar, të cilët sot janë struktur në ndonjë qoshe të padukshme, si edhe aty këtu ndonjëri ka siguruar disi ndonjë qoshe jo pak të ngrohtë e fitimprurëse! Qoshe të fituar jo nga meritat a vlerat personale që ka, por nga ajo se dikush në një kohë paska luftuar apo qenka flijuar për liri. Mbase ndonjëri i është lëpëtur ndokujt me "lepe e peçet" e tij. Kjo rrugë na është e njohur goxha mirë ne, shqiptarëve, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, më pastaj se ku e si na katandisi jeta shumëkush e di, po ta ketë jetuar atë kohë. Mbase edhe rrahagjoksit e asaj lufte, në të shumtën e rasteve u përpoqën të

fshiheshin pas meritave të luftës për ndërtimin e shtetit të pasluftës.

Sot, kur gati njëzet vjet pas po flitet për një temë të luftës së fundit, kush luftoi e kush jo, nuk është edhe punë e lehtë të flasësh me zë apo të shkruash shqip, pasi mund të t'i përfshijnë valët e sharjeve të turmës që në kohën e duhur nuk ka bërë, ama nuk ka bërë asgjë për lirinë, saqë përballet edhe me një mallkim të atyre që kanë bërë diçka, por që sot nuk e kanë asnjë ide se çka duhet bërë në rrethanat e reja të shtetndërtimit. Me një situatë të tillë, s'ka si mos të të shkojë mendja të fjala e urtë e popullit: "Me fol - serm, mos me fol - dukat!" Megjithatë, nganjëherë heshtja është qyqari, të folurit është guxim, është obligim. Mbase kësaj radhe në mes të arit e të argjendit duhet të zgjidhet argjendi. Argjendi edhe ashtu është një shumicë relative në natyrë sesa ari. Pra, të flasësh sot për 19 000 veteranët e paqenë (të verifikuar nga një prokuror), nuk dyshoj se ky numër mund të përfundojë aty, pasi në ndonjë zonë operative të luftës ka më së paku një trefishim të numrit të veteranëve në krahasim me numrin e ushtarëve të kohës së luftës. Për në asnjë zonë operative nuk janë dhënë numra realë të veteranëve në krahasim me numrin e

ushtarëve të kohës së luftës. Prokurori, ndoshta, nuk ka bërë mirë që është tërhequr, por edhe kaq sa ka bërë duhet mbështetur. Ai punën e vet fisnike dhe obligimin profesional e ka kryer me nder. I lumtë! Ndonëse, nuk mendoj se kjo çështje mund të zgjidhet me dënime drakonike. Zgjidhja e kësaj çështjeje duhet të jetë politike, pasi problemin e ka bërë politika dhe ajo duhet ta marrë dënimin e merituar. Në një situatë të tillë zyrtarët e lartë të shtetit, e veçanërisht përfaqësuesit e zgjedhur të popullit, që kanë fatin të jenë në tempullin e demokracisë, janë në pozitën më të vështirë të mundshme. Ata ose duhet të flasin shqip, me një gjuhë të rrjedhshme shqipe, ose nuk duhet t'u dëgjohej zëri fare. Për ata nuk vlen as fjala e popullit "me fol - serm, mos me fol - dukat!" Jo, për ta të mos flasësh është më shumë se diamant! Por, po qe se vendosin të flasin, duhet ta bëjnë zgjidhjen e duhur, në mbrojtje të shtetit që po e çojnë drejt falimentimit e assesit në mbrojtje të dembelisë e të mashtrimit bërë "vlëra" politike nga drejtuesit e shtetit.

Le ta themi shkurt e shqip: Nuk ka gjë më banale sesa kur një pjesëtar i UÇK-së, duke tentuar ta mbrojë një vepër të paligjshme, gati njëzet vjet pas lufte, thotë: "Filani a fisteku e ka humbur krejt

familjen e fshatin në luftë...!" Luftës Çlirimtare si dhe gjithë brezave luftëtarë padrejtësi më të madhe dhe devalvim më të madh nuk mund t'i bësh se kaq! Pse, mbi 600 shekujt e burgut që mbajtën shqiptarët pas Luftës së Dytë Botërore, 250 vetëm nga viti 1981-1991, mbi 80 000 viktimat e luftës (1944/1945 e deri këto të luftës së fundit 1987/1999 e dëmet e tjera të pallogaritshme, nuk qenkan bërë për shtetin e së drejtës, për shtetin e zhvilluar, për shtetin e dijës e të arsimimit dhe për shtetin e drejtësisë sociale? Apo shtetin e bëmë për debilët e dembelët e privilegjuar të pasluftës? Shtetin e bëjnë trimat, por e ndërtojnë dhe e përparojnë të diturit dhe punëtorët! Jo më kot Adam Smith shekuj më parë thoshte: "Pasuria e kombeve është puna"! Maskarenjtë e dembelët e bërë bashkë mund ta hanë vetëm shtetin dhe të ardhmen e kombit! Gardianët e meritueshëm të lirisë e kanë për obligim të bëhen gardianët më të vendosur të ardhmërisë së kombit ose le të kënaqen me ndonjë meritë! Por, mos ta ndalojnë ecjen progresive të kombit, përndryshe edhe meritat e njëmendta i merr lumi! Nuk kam asnjë dyshim, Republika e Kosovës, shtet i lirë, i pavarur, sovran e demokratik është vepër e atyre që kanë luftuar e sakrifikuar

gjithçka që kishin (e njeriu e ka vetëm një jetë!), për lirinë e pavarësinë që kemi sot. Por, edhe mbrojtja, edhe zhvillimi dhe përpunimi i shtetit duhet të bëhen nga të gjallët që flijuan shumë të afërm për këtë shtet. Ndoshta më se miri është që shtetin t'ua lëmë që ta bëjnë, ashtu siç deshën breza atdhetarësh, atyre që dinë e duan ta bëjnë e ta mbrojnë atë sa herë që të kërkohet. Se dikush, thotë i urti popull, në vend se t'i ngjet vetullat, t'i nxjerrë sytë! Shumëkush, nga të meritueshmit e djeshëm, sot po sillen aspak meritueshëm! Shih për këtë na vjen shumë keq, se kështu u është hapur goja gojëkëqijve që të sulmojnë çdo vlerë edhe pa pardon. Pra, nuk mbrohet lufta e shenjtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duke shpërndarë para për ta blerë pushtetin grabitqar që ta sjellë vota e veteranëve mashtrues! Prandaj, problemin që e kanë krijuar krerët e politikës sonë, nuk mund ta zgjidhë sistemi i drejtësisë. Zgjidhja e këtij problemi aspak të vogël mund dhe duhet të bëhet vetëm nga politika e politikanë që e duan shtetin pa hile! A thua kemi politikë e politikanë të tillë? Kjo, mbase, lë shumë për të dëshiruar! Unë besoj dhe shpresoj në ndryshimin e mundshëm, por me një qasje krejt ndryshe!



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik**  
*Ministarstvo Ekonomskog Razvoja*  
*Ministry of Economic Development*

*Ministria e Zhvillimit Ekonomik të gjithë  
qytetarëve të Kosovës të besimit islam ju uron  
festën e Kurban Bajramit!*



# Takimi Merkel - Putin në Gjermani, tema të ndjeshme

Në takimin në mes të kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit rus Vladimir Putin është biseduar për çështjet si Siria, Ukraina, marrëveshja bërthamore me Iranin dhe gazsjellësi rus "Nord Stream 2"

**BERLIN, 19 GUSHT** - Presidenti rus Vladimir Putin dhe kancelarja gjermane Angela Merkel zhvilluan të dielën bisedime dypalëshe në shtëpinë e pritjes së Qeverisë gjermane në Meseberg, në veri të Berlinit. Pjesë e agjendës së bisedimeve ishin Siria, Ukraina, marrëveshja bërthamore me Iranin dhe gazsjellësi rus "Nord Stream 2". Duke folur në konferencën me gazetarë përpara takimit, Merkeli theksoi nevojën për "të shmangur një katastrofë humanitare në qytetin Idlib të Sirisë dhe në zonat përreth tij". "Kemi përgjegjësi, Gjermania, në veçanti Rusia si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit, prandaj duhet të punojmë për ta gjetur zgjid-

hjen", tha Merkel. Putini i bëri thirrje Evropës të kontribuojë financiarisht për rindërtimin e Sirisë, gjë që do të mundësonte kthimin në shtëpitë e tyre të miliona refugjatëve. "Më lejoni t'ju kujtoj se një milion refugjatë gjenden në Jordani, një milion në Liban dhe tre milionë në Turqi. Kjo situatë mund të shndërrohet në një barrë të rëndë për Evropën. Pra, është mirë të bëhet gjithçka që këta njerëz të mund të kthehen në shtëpitë e tyre", tha Putini. Gjermania, e cila ka pranuar qindra mijëra refugjatë sirianë që iu larguan luftës, ka këmbëngulur në të kaluarën se nuk do të kontribuonte për rindërtimin e Sirisë pa arritjen e një



marrëveshjeje politike që do t'i jepte fund luftës. Për çështjen e Ukrainës, Merkeli foli mbi mundësinë e krijimit të një misioni të OKB-së për të ndihmuar në vendosjen e paqes në këtë vend. Putini theksoi rëndësinë e ruajt-

jes së marrëveshjes bërthamore me Iranin për ta forcuar sigurinë globale. Bashkëpunimi ekonomik, në veçanti në sektorin energjetik, u shfaq gjithashtu si temë qendrore në bisedime. Rusia dhe Gjermania janë vende partnere në projektin e

gazsjellësit Nord Stream 2, i cili është kritikuar nga Shtetet e Bashkuara, si një projekt që do ta rriste varësinë energjetike të Evropës nga Rusia, do ta dëmtonte Ukrainën - një vend kryesor transiti për gazin natyror, si dhe për rreziqet mjedisore.

## Trupat amerikane do të vazhdojnë të qëndrojnë në Irak

**UASHINGTON, 19 GUSHT** - Forcat e Shteteve të Bashkuara do të qëndrojnë në Irak për aq sa ka nevojë ta ndihmojnë stabilizimin e rajonit që ishte kontrolluar nga Shteti Islamik, deklaroi një zëdhënës i koalicionit për luftimin e militantëve. "Ne do t'i mbajmë trupat për aq sa ka nevojë. Arsyeja tjetër pas Shtetit Islamik është sta-



biliteti dhe ne duhet të qëndrojmë këtu", tha kolonel Sean Ryan. "Numri i ushtarëve amerikanë mund të ulet kur forcat e tjera të NATO-s do të zbarkojnë për të ndihmuar në trajnimin e forcave irakiane", shtoi Ryan. Ai ka theksuar se 5 200 trupa janë të vendosura në Irak për momentin.

## Ministri iranian paralajmëron lansimin e anijes luftarake

**TEHERAN, 19 GUSHT** - Ministri i Brendshëm iranian tha se vendi po vazhdon të fokusohet në zhvillimin e raketave ajrore dhe shumë shpejt pritet të shfaqë një aeroplan luftarak në kohën kur Shtetet e Bashkuara po vazhdojnë sanksionet ndaj programit bërthamor në Iran. "Prioriteti kryesor yni është zhvillimi i programit raketor", tha gjenerali Amir Hatami. "Ne



jemi në një pozicion të mirë në këtë fushë, por na duhet ta zhvillojmë atë", shtoi ai. Hatami tha se një aeroplan luftarak do të prezantohet në publik gjatë festimeve të Industrisë së Mbrojtjes Kombëtare më 22 gusht. Forca ajrore e Iranit ka pasur vështirësi në ndërtimin e kapaciteteve për shkak të sanksioneve ndërkombëtare.

## Besimtarët myslimanë fillojnë ritualin e haxhillëkut


**MEKË, 19 GUSHT** - Më tepër se dy milionë besimtarë myslimanë nga e gjithë bota filluan të dielën pelegrinazhin pesëditorë të haxhillëkut. Ata do të mbliidhen sipas ritualit, rreth objektit më të shenjtë për myslimanët, Kaabës në formë kubike, në Meka të Arabisë Saudite. Me këtë rast, besimtarët myslimanë marrin pjesë në një sërë ritesh, që synojnë t'ua përforcojnë atyre ndjenjën e përlusës dhe të unitetit në mesin e myslimanëve.

Haxhillëku është një prej pesë kolonave bazë të fesë islame; të gjithë myslimanëve fizikisht të shëndetshëm, u kërkohet të pak-tën një herë në jetë ta kryejnë këtë ritual. Haxhillëku shihet si një rast për t'i pastruar mëkatet e së shkuarës dhe për ta filluar jetën nga e para, i pastër moralisht.

Shumë njerëz, pasi kryejnë hax-

hillëkun, bëhen edhe më besimtarë se ç'kanë qenë; disa gra vendosin me këtë rast ta mbulojnë kokën me shami, që njihet si "Hijab", me t'u kthyer nga haxhillëku.

Me gjithë vështirësitë fizike të haxhillëkut, shumë njerëz që ecin me ndihmën e bastunit, apo të patericave, këmbëngulin ta kryejnë me këmbë këtë ritual. Njerëzit që nuk janë në gjendje ta përballojnë nga ana financiare udhëtimin e haxhillëkut, shpesh financohen nga organizata bamirësie, apo udhëheqës të komunitetit. Ka nga ata që kursejnë gjatë gjithë jetës së tyre për ta realizuar më në fund udhëtimin e tyre të haxhillëkut. Disa njerëz, madje, e ndërmarrin udhëtimin me këmbë, duke përshkruar për disa muaj me mijëra kilometra të Arabisë Saudite, për të arritur te vendi i shenjtë.



## Presidenti Erdogan rizgjidhet edhe kryetar i AKP-së

**ANKARA, 19** - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, u rizgjodh kryetar i Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP) me 1 380 vota, duke marrë të gjitha

votat e vlefshme. Kryetari i Kongresit të kësaj partie, Mehmet Ali Shahin, njoftoi se sipas rezultateve, nga 1 457 delegatë sa kanë votuar, 1

380 vota ishin të vlefshme dhe një ishte e pavlefshme. Shahini ka njoftuar se presidenti Erdogan, duke marrë të gjitha votat, ishte rizgjedhur

kryetar i përgjithshëm i kësaj partie. Po me të njëjtin votim është përcaktuar edhe bordi i ri drejtues dhe ai ekzekutiv i partisë.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CRYSTAL PALACE - LIVERPOOL

GG

ATHLETIC BILBAO - LEGANES

1

GIMNASTIC - TENERIFE

3+

# Superliga nis me befasi. Drita konfirmon kandidaturën për titull



**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 19 GUSHT** - IPKO Superliga e Kosovës në futboll ka nisur me befasi. Drenica ishte skuadra që u përkujdes për një gjë të tillë, pasi e mposhti në Podujevë Llapin (0-1). Ndërsa kampionia aktuale, Drita me fitoren bindëse ndaj KEK-ut e ka konfirmuar se mbetet sërish favorite në garë për trofeun më të çmuar në futbollin e Kosovës. Xhiro e parë mbyllet sot (e hënën) me ndeshjen ndërmjet Prishtinës dhe Gjilanit, e cila zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 19:45.

## Drita - KEK-u 5-0

Kampionia e Kosovës në futboll, Drita e ka nisur në mënyrën me të mirë mbrojtjen e titullit të kampiones, pasi e mposhti në Gjilan me rezultat

bindës, KEK-un (5-0). Nga dy gola për skuadrën vendase i shënuan sulmuesi Betim Haxhimusa dhe mesfushori Endrit Krasniqi, kurse një tjetër gol e shtoi nga penalltia mbrojtësi Fidan Gërbeshi. Drita pas një edicioni të suksesshëm ku doli kampion dhe me pas pati prezantim të mira në garat ndërkombëtare, arriti që të fitojë edhe Superkupën, kur në stadiumin "Fadil Vokrri" e mposhti Prishtinën (2-1).

## Llapi-Drenica 0-1

Pavarësisht investimeve të shumta dhe ndryshimeve në shtabin teknik, Llapi nuk ka arritur të marr pikë në ndeshjen ndaj Drenicës nga Skenderaj. Skuadra e Llapit është dashur të pajtohet me humbje në ndeshjen e zhvilluar të dielën në stadiumin "Zahir Pajaziti", pasi Drenica shënoi një gol në fund të pjesës së

parë, i cili doli të jetë përcaktues për fituesin e kësaj ndeshje. Autor i golit ishte Armend Abazi, derisa vendasit me çdo kusht e kërkuan golin e barazimit, por pa sukses.

## Liria - Ballkani 0-1

Ballkani nga Suhareka e ka vazhduar formën e mirë nga edicioni i kaluar, pasi e mposhti në ndeshjen e parë në elitë, Lirinë në Prizren (0-1). Skuadra e drejtuar nga Bekim Shotani ishte me fat, pasi golin e fitores e shënuan në minutën e katërt shtesë nëpërmjet maqedonasit, Borche Manevski. Një ndeshje tjetër e vështirë e pret Ballkanin në xhiron e dytë kur luan si vendas ndaj Llapit.

## Flamurtari - Ferizaj 1-0

Trajneri Arsim Thaqi ka debutuar me fitore në krye të shtabit teknik në skuadrën e

Flamurtarit. Kjo e fundit e mposhti të dielën skuadrën e rikthyer në elitë, Ferizajn (1-0). Goli i shënuar nga Alban Shillovës në minutën e 17-të, doli të jetë përcaktues për fituesin e kësaj ndeshje. Afrim Tovërlanit i mbetet të kërkojë pikët e para me skuadrën e tij në ndeshjen e dytë ndaj Lirisë së Prizrenit.

## Feronikeli - Trepça '89 1-1

Ish-dy skuadrat kampionë të Kosovës, Feronikeli dhe Trepça '89 kanë ndarë pikët në ndeshjen e zhvilluar të shtunën në Drenas, pasi rezultati final i ndeshjes ishte 1-1. Vendasit e dominuan pjesën e parë ku arritën edhe golin e parë nëpërmjet Mendurim Hoti (17). Mysafirët e barazuan rezultatit në minutën e 55-të, kur shënoi Gëzim Rusi. Trepça '89 xhiron e dytë e pret Prishtinën, kurse "Nikli" i shkon Drenicës.

## IPKO Superliga

Drita - KEK-u	5-0
Llapi-Drenica	0-1
Liria - Ballkani	0-1
Flamurtari - Ferizaj	1-0
Feronikeli - Trepça '89	1-1
Të hënën takohen:	
19:45 Prishtina - Gjilani	

### TABELA

	PIKË
1. Drita	3
2. Ballkani	3
3. Flamurtari	3
4. Drenica	3
5. Feronikeli	1
6. Trepça '89	1
7. Prishtina	0
8. Gjilani	0
9. Llapi	0
10. Ferizaj	0
11. Liria	0
12. Keku-u	0

Në xhiron e dytë takohen: KEK-u-Gjilani, Trepça '89-Prishtina, Drenica-Feronikeli, Ballkani-Llapi, Ferizaj-Liria, Drita-Flamurtari.


## Valverde: Messi është gjeni

Barcelonë, 19 gusht - Trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde, ka thënë se tifozët e futbollit duhet të ndihen me fat që e kanë mundësinë t'i shohin performancat e jashtëzakonshme të Lionel

Messit. Argentinasi e ndihmoi Barcelonën t'i sigurojë tri pikët e para të sezonit të ri të La Ligës në ndeshjen kundër Deportivo Alavesit. "Messi është gjeni. Jemi me fat që e shohim çdo ditë. Jemi me fat

që jemi të përfshirë me futbollin në epokën në të cilën ai luan futboll. Në kërkujmë nga ai që të nxjerrë nga kapela çdo ditë", ka thënë Valverde. "Ka ende vend për Messin që të na befasojë. Ai

gjithmonë na befason. Ai kurrë nuk ndalet së më habituri mua, sinqerisht. Duhet të jesh gati të presësh gjithçka nga Messi sepse ai sheh atë që askush tjetër nuk e sheh", ka deklaruar Valverde.



## Zollneri, trajner i KB Prishtina

PRISHTINË, 19 GUSHT - Trajneri i mirënjohur gjerman, Matthias Zollner, do të jetë kryetrajner i skuadrës së Prishtinës për edicionin e ri 2018/19. Në vazhden e përgatitjeve për stinorin e ri, Prishtina po bëhet gati të përfaqësohet në Evropë në mënyrën më të mirë të mundshme, andaj klubi kryeqytetas ka angazhuar një trajner të ri në moshë, por me shumë përvojë dhe suksese. Gjermani 37-vjeçar më herët ka drejtuar disa skuadra. Fillimisht udhëhoqi ekipin e vendlindjes së tij, TSV Dachau për pesë vjet, ku pastaj u zgjodh në krye të ekipit të famshëm gjerman, Munich Basket. Pas sukseseve të skuadra "bavareze", Zollner emërohet ndihmëstrajner i Gjermanisë. Përvoja që mori në kombëtaren gjermane u vë në pah me skuadrën austriake, UBC Gussing Knights. Pavarësisht se konsiderohej ekip që do të luftonte për ekzistencë, Zollner bëri mrekullinë duke arritur të shpallte Knights kampionë të Bundesligës austriake, njëkohësisht duke fituar edhe çmimin si "Trajneri i Vitit". Vetëm një vit më vonë përsëriti suksesin e njëjtë, duke u bërë trajneri i vetëm që fiton ligën dy herë radhazi. Në këtë edicion ai shkroi historinë në



basketbollin austriak duke u kualifikuar në TOP 16 të Eurochallenge. Së fundmi Matthias Zollner ishte trajner i Kombëtares së Austrisë në kualifikimet për Kampionatin Botëror. KB Prishtina pas trajnerit e ka zyrtarizuar edhe një përforcim. Bëhet fjalë për organizatorin amerikan Kyan

Anderson. 26-vjeçar ishte pjesë e kolegjit TCU, ku për katër vjet kishte performancë të jashtëzakonshme, duke u bërë një ndër shënuesit më të mirë në histori të këtij kolegji. Si profesionist Andersoni karrierën e nisi në Belgjikë tek Okapi Aalstar, kurse ka përvojë edhe në Gjermani dhe Francë.

## Strakosha: Harrojeni humbjen, përqendrim te Juventusit

ROMË, 19 GUSHT - Lazio e nisi kampionatin me një humbje 1-2 përballë Napolit në "Olimpico", ndërsa portieri i Kombëtares Shqiptare, Thomas Strakosha, ishte titullar në këtë humbje. Shqiptari pas ndeshjes ka kërkuar të harrohet kjo humbje dhe skuadra të përqendrohet në ndeshjen e radhës ndaj Juventusit të Cristiano Ronaldos. "Dominuam për 30 minuta në pjesën e parë, por pastaj u ndjemë të lodhur. Napoli u rrit falë cilësive që ka në ekip dhe na shënoi. Goli i tyre në pjesën e dytë na preu këmbët, ndërsa ne e kërkuam një gol, por nuk erdhi. Megjithatë, nuk duhet të kërkujmë alibi, por as ta kthejmë në tragjedi, pasi është vetëm java e parë. Të shtunën na pret Juventusit. Me të gjitha ekipet mund të fitosh dhe të hum-



basësh", ka thënë Strakosha. Portieri shqiptar është shndërruar një pikë fikse, në formacionin e Simone Inzaghit, ndërsa edhe në ndeshjen ndaj Napolit tregoi se e meriton besimin që i është dhënë.

Strakosha ndërhyri duke bërë disa pritje të mira, ndërsa në asnjë prej golave nuk ishte faktor, pasi lojtarët e Napolit shënuan nga fare pranë dhe kryesisht për gabime të mbrojtjes bardhekaltër.

### SHKURT

#### Ronaldo i lumtur për fitoren e parë me Juven

Cristiano Ronaldo luajti për 90 minuta, por nuk realizoi asnjë gol për fanellën e Juventusit në fitoren 3-2 ndaj Chievo Veronas. Ronaldo është i kënaqur me paraqitjen e tij dhe mbi të gjitha me fitoren e vështirë që "Zonja e Vjetër" e arriti në javën e parë. "I lumtur për fitoren time të parë me fanellën e Juventusit", ka shkruar Ronaldo.

#### Ancelotti: Milik si Shevchenko

Arkadiusz Milik ka shënuar njërin nga golat e fitores për Napolin në ndeshjen ndaj Lazios (1-2). Pas ndeshjes trajneri Carlo Ancelotti e ka lavdëruar sulmuesin Milik, duke thënë se ka ngjashmëri me Andriy Shevchenkon. "Mund të them se Milik më kujton Shevchenkon. Do të shënojë shumë gola sivjet për ne", ka thënë Ancelotti.

#### Hazardi: Për të ardhmen flasim pas dy vjetësh

Eden Hazard ndihet i lumtur në skuadrën e Chelseat. Ai ka konfirmuar se do të qëndroj deri në fund të kontratës dhe më pas do të vendosë për të ardhmen. "Jam i lumtur dhe do të qëndroj tek Chelsea. Kam ende edhe dy vjet kontratë, do t'i respektoj ato dhe më pas të shohim se çfarë do të ndodhë. Afati kalimtar në Angli është e mbyllur, skuadrat mund t'i shesin lojtarët, por unë nuk do të largohem. Unë pashë edhe një herë se fansat më duan, ndaj jam mirë këtu ku jam. Për të ardhmen flasim pas dy vjetësh", ka thënë Hazardi.

#### Reali, 70 milionë euro për Cavanin

Real Madridi ka kthyer vëmendjen kah sulmuesi i Paris Saint-Germainit, Edinson Cavani, sipas "Diario Gol". "Los Blancos" po kërkon rival për Karim Benzeman dhe janë të gatshëm të shpenzojnë deri 70 milionë euro për uruguaiianin. Sulmuesi i Lyonit, Mariano Diaz, dhe ai i Bayernit, Robert Lewandowski, janë emrat e tjerë në listën e kampionëve të Evropës.

#### Phelpsi ende vuan nga depresioni

Pas një karriere të mbushur me medalje të arta dhe rekorde, Michael Phelps e ka pranuar se ai shpeshherë është përballur dhe përballet ende me depresionin. 23 herë medalisti i artë gjithashtu ka folur hapur për trajtimin që e ka marrë për problemet e tij me alkoolin dhe ka theksuar se ka filluar të punojë me një terapist për t'i zgjidhur problemet e tij e kjo gjë i ka ndihmuar shumë. "Para dy ose tri javëve, vuaja nga një fazë e tmerrshme depresioni. Kjo është diçka që do të vazhdojë të më ndodhë gjatë jetës sime, por sa më shumë të mësoj për veten, aq më shumë mund ta kuptoj se pse më ndodhin këto gjëra", ka thënë Phelps. "Unë nuk doja të shihja një terapist në fillim, por pastaj e kuptova se isha më mirë dhe më i shëndetshëm, dhe mësova shumë gjëra për veten, të cilat nuk i dija më herët", ka shtuar ai. Tani, Phelps është i martuar, ka dy fëmijë dhe dëshiron t'i ndihmojë të gjitha ata të cilët vuajnë nga simptoma të ngjashme me të. "Do të doja ta shpëtoja jetën e dikujt. Do të ishte më e rëndësishme sesa fitorja e medaljes së artë".

#### Barça nuk e dëshiron Yaya Touren

Barcelona hedh poshtë çdo mundësi të rikthimit të Yaya Toure në "Camp Nou". Siç deklarojnë zyrtarët e klubit të futbollit të katërfisht të Ligës së Kampionëve, arsyet kryesore të refuzimit të përfaqësuesit nga Bregu i Fildishtë janë mosha dhe kërkesa për pagë të lartë. 35-vjeçari është parë si alternativë nëse Barcelona nuk do të mund ta transferonte Paul Pogban nga Manchester United. Por, duket se asnjëra nuk do të ndodhë këtë verë, shkruan "Goal". Toure është pa ndonjë angazhim, pas largimit nga Manchester City si transferim i lirë. Ai ka qenë pjesë e Barcelonës në të kaluarën për tre sezone.



Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nxënësve	Vitet	
Prishtinë	Shmlp "Shtjefën Gjeçovi"	Makincri	Dirigjim kompjuterik i makinave	1	12	2+1	
			Metalpunues	1	14	2+1	
			Saldator	1	16	2+1	
			Automekanik	2	0	2+	
			Instal. i ngroh. Kimatizi.	2	0	2+1	
			Instalues i ujit dhe kanaliz.	1	8	2+1	
		Transport dhe Trafik	Transport rrugorë	2	12	2+1	
			Drejtues i trenave	1	20	2+1	
		Tekstil	Konfeksioner	2	0	2+1	
			Rrobaqepesi	1	0	2+1	
				Gjithsej - "Sh. Gjeçovi"	14	82	

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nxënësve	Vitet	
Prizren	Qendra e Kompetencës	Ekonomi	Nepunes industric	1	4	2+1	
			Nepunes finance- statistikë	1	15	2+1	
			Nepunes per administrim ne zyre dhe menaxhim	1	16	2+1	
		Tregu	Sherbimet ndaj konsumatorit dhe shitjes	1	17	2+1	
			Nepunes i eksport-import	1	20	2+1	
		Turizem	Udheheqes i udhetimeve dhe grupeve turistike	1	3	2+1	
			Asistent ne zyra informimi dhe agjenci turistike	1	5	2+1	
			Asistent ne organizimin e ngjarjeve ( Eventimeve)	1	19	2+1	
				Gjithsej - QK - Prizren	8	99	

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nxënësve	Vitet	
Malishevë	Qendra e Kompetencës	Administratë	Administratë dhe shërbime të zyrës	3	56	2+1	
			Elektroinstalues	1	9	2+1	
			Agrobiznes	1	30	2+1	
		Ekonomi	Banka dhe shërbime të sigurimeve	1	32	2+1	
			Shitje dhe marketing	2	15		
			Shërbime të TIK-ut	1	15	2+1	
			Logjistikë dhe operim në magazinë	2	36	2+1	
			Hoteleri dhe turizem	1	11	2+1	
				Gjithsej - QK - Malishevë	12	204	

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perlleshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.
- Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtër. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151
- Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall i frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall i frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ar, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/giejpuneshpeite



Qendra për Mjekësi Fizikale  
dhe Rehabilitim

# Nëna Naile

Banja në Kllokot - Kosovë



Tel&Fax: 0280 385 101, 0280 385 555 • Mob: 044 666 006, 045 385 555 • info@nenanaile.com • www.nenanaile.com



*Tek ne do të gjeni ngrohtësi në katër stinët e vitit ...!*

**Të gjithë qytetarëve të Kosovës të besimit islam ju uron festën e Kurban Bajramit!**

E jashtëzakonshme

### 16 infermiere shtatzënë në të njëjtën kohë

Një spital në Arizona (ShBA) ka historinë më të bukur. 16 infermiere, punonjëse të këtij spitali, janë shtatzënë në të njëjtën kohë. Sipas BBC-së, 10 për qind e stafit femëror të infermierëve po presin të bëhen nëna dhe kjo ka habitur edhe pacientët. Këta të fundit kanë mbetur të befasuar kur kanë marrë



shërbim nga gjithë ato infermiere shtatzëna. Lindja e parë e këtij grupi pritet të jetë në shtator dhe e fundit në janar.

FOTO E DITES



Fotografi e realizuar në autostradë pak para lindjes së diellit në Frankfurt. /AP/

E rrallë

### Indonezi, dyvjeçari që pinë një paketë cigare në ditë

Rapi Ananda Pamungkas ishte vetëm dymuajsh kur filloi t'i fuste në gojë bishtat e cigares në tezgën e tregut të nënës së tij në Sukabumi, Indonezi. Dhe varësia e tij u përshkallëzua kur blerësit që kalonin nga tregu filluan t'i jepnin cigare. Pothuajse dy muaj më vonë, Rapi u bë i



varur plotësisht nga duhani dhe thuhet se pinë duhan të paktën një paketë në ditë.

BARSOLETA E DITËS



- Burri kthehet i dehur në shtëpi, gruaja nuk ia hap derën.
- Kam lule për gruan më të bukur në botë, thotë ai. Gruaja e hap derën.
- Ku janë lulet?
- E ku është gruaja më e bukur në botë?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjate vikendit në ora 16:00

### “INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird




Në ora 18:20

### “FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

### “ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



Në ora 22:00

### “LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.

 <p><b>DASHI</b> Nëse nuk doni t'ju kritikojnë sot, duhet patjetër të sqaroni një situatë të ndërlikuar që ka prekur jo pak njerëz. Ju keni gjeneruar gjithçka.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot do t'ju anulohen të gjitha planet që keni bërë për ditën. Kjo si pasojë e një çështje që do të dalë papritur dhe kërkon zgjidhje emergjente.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Mbase keni shpresuar më tepër sesa që duhet në disa ngjarje që nuk kanë ndodhur ende. Bëni një bilanc të ditës tuaj dhe ndryshoni qëndrim.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Mos lejoni që sot të neglizhohet një projekt i caktuar që ka afatet e veta. Nëse ndodh kjo, të gjitha pasojat do të bien mbi ju.</p>	 <p><b>LUANI</b> Ka disa mundësi sot për të dalë nga një situatë e bezdisshme që po ju shqetëson. E rëndësishme është të zgjidhni atë që bie më pak në sy.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Nuk ka pse t'ju kapë paniku për gjëra që nuk janë verifikuar ende. I keni të gjitha mënyrat për ta sqaruar pozicionin tuaj.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Nëse nuk doni të përshkoni shumë rrugë sot për të arritur në përfundimet e kërkua, duhet t'i besoni intuitës suaj që ju ka zgjidhur gjithmonë punë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sot doni të jeni sa më pranë personave që punojnë me ju. Mbase duhet të kuptoni dhe nevojat e tyre dhe të mos tregoheni egoist.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Po përçoni stres tek personat afër jush sepse dhe ju vetë në këto çaste jeni shumë të ngarkuar. Ruani qetësinë dhe kërkon mbështetje.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Nëse nuk keni arritur të zgjidhni një problem familjar, sot duhet t'ia kushtoni gjithë kohën e nevojshme. Edhe familja ka kërkesat e veta.</p>	 <p><b>UJORI</b> Meqë tani jeni në lojë duhet të filloni të ecni sipas rregullave të lojës. Prisi kohën tuaj dhe veproni me maturi për të qenë sa më të sigurt.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Keni marrë disa vendime që ju kanë vënë në mendime sot. Mbase nuk ishte mënyra e duhur ajo që zgjidhët për t'i bërë publike.</p>

# Urimë festa e Kurban Bajramit!

